



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMLORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2024:043431

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05727647

C.nr.1137/2023

GJYKATA THEMLORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Avdulla Mecinaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit K.K., të cilin e përfaqëson me autorizim Q.R. avokat në Skenderaj, kundër të paditurës Komuna Skenderaj – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson E.Ç., për kompensim të ushqimit gjatë punës, duke vendosur sipas marrëveshjes së palëve të arritur nga ndërmjetësuesi, N.O., ndërmjetësues i licencuar, bazuar në nenin 15 paragrafi 1 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim dhe pas vlerësimit të marrëveshjes së palëve të arritur në ndërmjetësim, me dt.23.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

1. APROVOHET Marrëveshja ND: 572/2024 e dt.14.03.2024 e arritur në procedurën e ndërmjetësimit në lëndën C.nr.1137/2023.
2. Marrëveshja e arritur në ndërmjetësim e fiton fuqinë e vendimit të formës së prerë dhe dokumentit përmbarues sipas dispozitave ligjore në fuqi përfshirë këtu edhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.
3. Vendimi iu dorëzohet palëve dhe kundër të njëjtit, sikurse edhe kundër marrëveshjes së arritur, palët nuk kanë të drejtë ankese.
4. Prishjen apo anulimin e marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim, palët kanë të drejtë ta kërkojnë vetëm me padi të veçantë në procedurë të veçantë gjyqësore.

Gjyqtari
Avdulla Mecinaj